

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gjykata e Lartë kundër projektligjit për pagat e magjistratëve: Kuvendi të mos e votojë
ADRESA	https://kohajone.com/lajme/gjykata-e-larte-respektimi-i-kushtetutes-dhe-i-vendimeve-te-gjykates-kushtetuese-nuk-eshte-opsional/
BURIMI	kohajone.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 13:23:04 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 13:19:20 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	725fbef7c6e04ad6e543f0fb2d948357d7d7e0a06aeafacdf9b9c133bfcc4e2e
TEKSTI	8df073e0fc446f2945a239be62eeab29e0656ffd614e7868936a0a27559bfa15
PAMJA	e7cf97ee3f57c1781952ea351c13cf66343124c6354a55c5404311a9a90856a3

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f299400828615acf527c23f3a08109cc7467035f81fa00d711f38c25b2bb84c5
E MËPARSHMJA	6615de5dd354863700bb5dfcb3020373a7eb54c1b60ea2524554eda1499218c9
RRËNJA MERKLE	485c8b8c8ba28305218c58e8c7791d525f1a193166e89422b0670a53018cd566
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f299400828615acf527c23f3a08109cc7467035f81fa00d711f38c25b2bb84c5>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Gjykata e Lartë kundër projektligjit për pagat e magjistratëve: Kuvendi të mos e votojë

LAJME E MËRKURË, 16 SHTATOR 2026 15:19



Gjykata e Lartë shpreh kundërshtimin e saj më të fortë ndaj mënyrës se si Komisioni për Çështjet Ligjore zhvilloi procedurën parlamentare për projektligjin që prek drejtpërdrejt pagat, statusin dhe garancitë kushtetuese të magjistratëve. Ajo që ndodhi nuk ishte thjesht një konsultim i mangët. Ishte një shpërfillje e hapur e kuptimit të konsultimit institucional dhe e përfaqësuesve të një pushteti kushtetues, të thirrur nga vetë Kuvendi për t'u dëgjuar.

Kjo deklaratë nuk është reagimi i parë i gjyqësorit. Ajo vjen pas qëndrimit publik të Gjykatës së Lartë të datës 2 shtator 2026, reagimit të kryetarëve të gjykatave të Republikës, deklaratave të shoqatave të magjistratëve dhe, në veçanti, Deklaratës së Mbledhjes së Përgjithshme të Gjyqtarëve. Gjyqësori ka folur qartë, publikisht dhe institucionalisht. Ka kërkuar zbatimin e Kushtetutës, respektimin e vendimit nr. 15/2026 të Gjykatës Kushtetuese dhe një zgjidhje ligjore që të mos cenojë statusin dhe pavarësinë e magjistratit.

Përfaqësuesit e gjyqësorit u njoftuan për më pak se dy orë përpara për t'u paraqitur në Komision. Ata nuk e përdorën këtë afat të papërshtatshëm si arsye për të mos marrë pjesë dhe nuk kërkuar shtyrjen e dëgjësës. Përkundrazi, duke vlerësuar seriozitetin e situatës dhe përgjegjësinë e tyre institucionale, u paraqitën përpara Komisionit dhe morën pjesë në konsultim. Pikërisht për këtë arsye, mënyra se si u trajtuan më pas është edhe më e papranueshme.

LAJMET KRYESORE



Presidenti Begaj reagon pas vendimit të Gjykatës në Hagë: Trishtim i thellë! Askush nuk e njollos UÇK-në



Tensione pranë Gjykatës Speciale në Hagë



Vendimi tronditës! Gjykata Speciale dënon Hashim Thaçin, Jakup Krasniqin, Kadri Veselin dhe Rexhep Selimin



Dita e verdiktit, Gjykata Speciale jep sot vendimin për ish-krerët e UÇK-së



Videokartolinë e një dite të bukur miqësie dhe përbashkësie në Napoli

TË PËRZGJEDHURA



Edmond Spaho te Nikoll Lesi: PD ka mbaruar, nuk vjen ne pushtet!



Luka Modric konfirmon pjesëmarrjen me Kroacinë në Ligën e Kombeve



Dëshirat e Spalletit dhe blerjet e Juventus-it



Tesla, drejtimi gjysmë-autonom drejt përshtatjes me rregullat evropiane, thotë Franca



Shpërthen Erion Braçe te Nikoll Lesi në KOHA JONË-DEBAT: Nuk votoj kandidat me "njoftim"!

MË TË LEXUARAT

Gjykata e Lartë kishte paraqitur një opinion të plotë juridik dhe kushtetues, të përcjellë nëpërmjet Këshillit të Lartë Gjyqësor në Kuvend. Ai nuk mbronte një interes të veçantë të Gjykatës së Lartë, por ngrinte problematika që prekin gjyqësorin në tërësi: pagën referuese dhe raportin e saj me koeficientin 0,38 të pagës së Presidentit të Republikës; efektet pas datës 31 korrik 2026; trajtimin e pagave të prapambetura; ruajtjen e hierarkisë së pagave brenda sistemit gjyqësor; si dhe detyrimin që ndërhyrja e re ligjore të respektojë në substancë vendimin nr. 15/2026 të Gjykatës Kushtetuese.

Megjithatë, përfaqësuesit e gjyqësorit u dëgjuan pa iu vënë në dispozicion të gjitha amendamentet që ndryshonin projektligjin, mbi të cilin ishin thirrur të shpreheshin, pa informacion të plotë mbi opinionin financiar të Qeverisë dhe pa mundësinë për të dhënë qëndrim mbi tekstin që realisht po merrte formë për votim. Nuk mund të thërrasësh një pushtet kushtetues për konsultim dhe, në të njëjtën kohë, t'i mbash të panjohura elementet mbi të cilat do të marrësh vendimin. Kjo cenon seriozitetin dhe integritetin e vetë procedurës parlamentare.

Po aq shqetësues është fakti se dëgjesa nuk solli asnjë reflektim të dukshëm mbi argumentet e paraqitura. Përfaqësuesit e gjyqësorit dhe grupet e interesit ngritën gjerësisht shqetësime konkrete për mospërputhjen e projektligjit me standardet kushtetuese, por projektligji u procedua pa iu dhënë përgjigje këtyre argumenteve. Konsultimi nuk është një formalitet; ai duhet të jetë efektiv dhe të dëshmojë se qëndrimet e paraqitura janë shqyrtuar realisht. Pikërisht rëndësinë e këtij standardi e ka evidentuar edhe Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 15/2026.

Gjyqësori nuk mund të thirret në Kuvend vetëm për të plotësuar formalisht një procedurë. Gjyqësorit nuk mund t'i kërkohej mendim për një tekst, të mos reflektohet mbi argumentet e tij dhe më pas të procedohet mbi një tekst të ndryshuar pa i dhënë mundësinë të shprehet për të. Një proces i tillë e redukton konsultimin në formalitet dhe cenon besimin në seriozitetin e procedurës parlamentare.

Kontrasti i së njëjtës ditë është domethënës. Në Romë, drejtues të institucioneve të drejtësisë shqiptare u pritën në Quirinale nga Presidenti i Republikës Italiane, Sergio Mattarella, në kuadër të organizimit në Tiranë të World Law Congress 2027, një përgjegjësi e rëndësishme ndërkombëtare që i është besuar Shqipërisë dhe institucioneve të saj të drejtësisë. Në Tiranë, ndërkohë, përfaqësuesit e gjyqësorit thirren nga Kuvendi për konsultim, por pa iu bërë i njohur plotësisht teksti mbi të cilin do të vendosej. Respekti institucional që i tregohet drejtësisë shqiptare në marrëdhëniet ndërkombëtare duhet t'i garantohet asaj, para së gjithash, brenda vendit.

Edhe më shqetësues është trajtimi që i është bërë vendimit nr. 15/2026 të Gjykatës Kushtetuese. Problemi nuk është referimi formal të vendimit nr. 15/2026, por reflektimi i arsytimit të tij kushtetues në zgjidhjen ligjore të propozuar. Përmbytja e projektligjit dhe mënyra se si ai është proceduar tregojnë se ky arsyetim nuk është reflektuar.

Gjykata Kushtetuese ka folur qartë. Ajo ka përcaktuar kufijtë kushtetues brenda të cilëve ligjvënësi mund të ndërhyjë në pagën e magjistratit dhe pasojat që lidhen me shfuqizimin e formulës së mëparshme. Ligjvënësi ka të drejtën të gjejë zgjidhjen normative, por jo të sillt sikur vendimi i Gjykatës Kushtetuese nuk ekziston.

Pikërisht këtu qëndron problemi themelor i projektligjit. Nëse arsyetimi i vendimit nr. 15/2026 do të ishte reflektuar në tërësinë e tij, një projektligj me këto zgjidhje nuk mund të paraqitej në këtë formë. Kjo është veçanërisht serioze për Komisionin përgjegjës për Çështjet Ligjore. Nga një komision parlamentar që shqyrton kushtetutshmërinë dhe cilësinë juridike të legjislationit pritet jo thjesht të citojë një vendim të Gjykatës Kushtetuese, por të analizojë dhe të reflektojë arsyetimin e tij në normën që propozon për votim. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk respektohen duke iu referuar numrit të tyre; respektohen duke zbatuar përmbytjen dhe arsyetimin kushtetues që ato imponojnë.

Nuk mund të anashkalohet as koha kur u ndërhy sërish në projektligj. Pikërisht pasi gjyqësori kundërshtoi publikisht bllokimin e pagave dhe kërkoj zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese, u paraqitën ndryshime të reja që e vendosin atë në një pozitë edhe më të pafavorshme. Kur kjo ndërhyrje në statusin dhe garancitë financiare të gjyqtarëve bëhet pa transparencë të plotë dhe pa konsultim real me ta, lind një dyshim serioz për karakterin penalizues të saj. Komisioni duhet ta sqarojë këtë dyshim, jo ta thellojë atë me mungesë transparence. Gjyqësori nuk mund të penalizohet sepse kërkon zbatimin e Kushtetutës dhe të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Gjyqësori ka treguar përgjegjësi dhe vetëpërmbytje edhe në një situatë kur gjyqtarët dhe administrata gjyqësore janë përballur me bllokimin e pagave. Kjo përgjegjësi nuk duhet ngatërruar me dobësi dhe heshtja institucionale nuk mund të kërkohej si çmim për dialogun. Gjyqësori nuk pranon arrogancën e askujt që ushtron pushtetin sikur ai të ishte i pakufizuar dhe i pakontrollueshëm. Në Republikën e Shqipërisë nuk ka pushtet mbi Kushtetutën dhe nuk ka pushtet të përjashtuar nga kufijtë dhe kontrolli kushtetues.

Gjykata e Lartë nuk kërkon epërsi ndaj Kuvendit, por nuk pranon as nënshtrimin e gjyqësorit ndaj tij. Ndarja e pushteteve nuk njih hierarki ndërmjet tyre. Një kompetenca, kufij dhe kontroll kushtetues.

Në këto rrethana, Gjykata e Lartë i kërkon Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të mos kalojë për shqyrtim dhe miratim në seancën plenare të datës 17 shtator 2026 projektligjin në gjendjen në të cilën ndodhet.

Përpara çdo procedimi të mëtejshëm, Kuvendi duhet:

Të sqarojë rregullsinë, kohën dhe mënyrën e depozitimit e të shqyrtimit të amendamenteve, si dhe arsyen pse ato nuk iu bënë të njohura gjyqësorit gjatë konsultimit;

Të bëjë publik mendimin e Këshillit të Ministrave për efektet financiare, datën e paraqitjes së tij, tekstin mbi të cilin është dhënë dhe efektet financiare që ka ndërruar;

shprehë një shprehje mbi faktin që ka përdorur,

Të verifikojë respektimin e procedurave dhe afateve parlamentare për paraqitjen dhe shqyrtimin e ndryshimeve të projektligjit;

T'i japë gjyqësorit mundësinë reale të shprehet mbi variantin që tashmë është bërë publik dhe që synohet të votohet;

Të rivlerësojë projektligjin në tërësi në raport me vendimin nr. 15/2026 të Gjykatës Kushtetuese dhe me qëndrimet e paraqitura nga gjyqësori.

Kuvendi nuk duhet të votojë një projektligj kur ekzistojnë pikëpyetje kaq serioze mbi rregullsinë, transparencën dhe integritetin e procedurës me të cilën ai ka mbërritur për votim. Vazhdimi i procedurës nuk do t'i korrigjonte këto mangësi serioze, por do t'i mbartte ato në vetë vendimarrjen plenare.

Gjyqësori ka folur. Gjykata Kushtetuese ka vendosur. Tashmë përgjegjësia është e Kuvendit.

Kuvendi miraton ligje, por nuk mund të relativizojë Kushtetutën. Mund të zgjedhë zgjidhjen ligjore, por nuk mund të anashkalojë një vendim përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese. Mund të ftojë gjyqësorin për konsultim, por nuk mund ta përdorë praninë e tij për të legjitimuar një konsultim që realisht nuk ka ndodhur.

Gjykata e Lartë dhe gjyqësori nuk kërkojnë privilegje. Kërkojnë respektimin e Kushtetutës, të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe të dinjitetit të një pushteti të pavarur. Për këto nuk ka dhe nuk do të ketë tërheqje.

MË SHUMË NGA LAJME



Dënimi i krerëve të UÇK, Berisha: I padrejtë dhe i pamerituar

Erion Braçe: UÇK-ja u quajt ndërmarrje kriminale! Shqipëria të ndërma...

Çmimi i naftës, qeveria rikthen Bordin e Transparencës

Shkëlqim Hajdari: Seancë urgjente, e jashtëzakonshme e Parlamentit të...

Ish-krerët e UÇK-së u dënuan, por çfarë pritet të ndodhë më pas

Dënohen krerët e UÇK-së, reagon Edi Rama: Marre!

LAJMET E FUNDIT

Protestë para EULEX-it në Prishtinë pas aktgjykimit ndaj ish-krerëve të UÇK-së

[12 MINUTA MË PARË](#)

Conte rikthehet në orbitën e Juventusit, ja skenari që po qarkullon

[27 MINUTA MË PARË](#)



Gjykata e Lartë kundër projektligjit për pagat e magjistratëve: Kuvendi të mos e votojë

[32 MINUTA MË PARË](#)

Historia mund të gjykohet, por jo të rishkruhet

33 MINUTA MË PARË

Serbia reagon pas dënimeve në Hagë

39 MINUTA MË PARË

Avokati i Thaçit tregon bisedën e parë me ish-presidentin pas dënimit në Hagë

1 ORË E 19 MINUTA MË PARË

MË SHUMË LAJME TË FUNDIT >

Gazeta "KOHA JONË" themeluar si e pavarur më datë 11 Maj 1991
Botues: Nikoll LESI. Adresa e redaksisë: Rruga "Sami Frasheri", Pallatet e Aviacionit të Vjetër Nr. 2, TIRANA - ALBANIA

TË FUNDIT

LAJME

SPORTI

EKONOMI

EDITORIAL

WEBTV

AKTUALITET

RAJONI

KOSOVA

BOTA

TEKNOLOGJI

SHOWBIZ

SHËNDETI

SOCIALE

TURIZËM

KURIOZITETE

KULTURA

HISTORIKU

KONTAKT

BOTUES & DREJTOR: Nikoll LESI

KRYEREDAKTOR: Daniel MUÇAKU

ZV/KRYEREDAKTOR: Redjon SHTYLLA

BORDI: Elsa KAMBERI, KRYETARE

NIPT: J71425013C



NDËRTUAR DHE MIRËMBAHET NGA



© 2024 KOHA JONË. All rights reserved.

PRIVACY POLICY

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.